

V E N D I M
Nr. 66, datë 7.3.2002

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALTËS PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratohet marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maltës për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALTËS MBI
HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Maltës, më tej të quajtura Palë Kontraktuese,

Me dëshirën për të lehtësuar hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre ndërmjet dy vendeve,

Kanë rënë dakort si më poshtë:

Neni 1

Anëtarët e Misioneve Diplomate dhe Konsullore dhe Organizatave Ndërkombëtare të akredituara në secilin shtet, ashtu si dhe anëtarët e familjeve të tyre, si dhe mbajtësit e tjerë të pasaportave diplomatike do të kenë të drejtën të hyjnë pa vizë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Atyre do t’u jepet e drejta e qëndrimit për 30 ditë pas mbërritjes.

Neni 2

Hyrja dhe dalja e qytetarëve të shteteve të Palëve Kontraktuese, mbajtjes të pasaportave diplomatike, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të bëhet nëpërmjet pikave zyrtare të hyrjes në të dy vendet.

Neni 3

Kjo Marrëveshje nuk përjashton qytetarët e të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit tjetër.

Neni 4

Secila Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën të refuzojë hyrjen e qytetarëve të Palës tjetër

Kontraktuese ose të revokojë autorizimin e qëndrimit të dhënë më parë për këta persona, nëse ata kryejnë shkelje ndaj ligjeve dhe rregullave të tij.